



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E PROKURIMIT KOMUNA E PEJËS

Njesia e Prokurimit

Peje, datë, 22.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Pejes, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L- 237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 20.04.2025 me titull LOT 4-Rekonstruimi i trotuarit në lagjen Fidanishte pranë rruges kryesore Nr. të Prok: 635-25-108-5-1-1 dhe nr i brendeshen 635-25-003-511 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet – kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik LURN SH.P.K.; Albani AA L.L.C. . të datë 20.04.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit LOT 4-Rekonstruimi i trotuarit në lagjen Fidanishte pranë rruges kryesore Nr. të Prok: 635-25-108-5-1-1 dhe nr i brendeshen 635-25-003-511 nxjerr:

kundër B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK, të datës 16.04.2025 të publikuar në platformën elektronike të E- Prokurimit .

Vërtetohet vendimi i A.K mbi B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 16.04.2025

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik LURN SH.P.K.; Albani AA L.L.C.me datën 20.04.2025 , ka parashtruar kërkesën për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: LOT 4-Rekonstruimi i trotuarit në lagjen Fidanishte pranë rruges kryesore Nr. të Prok: 635-25-108-5-1-1 nr i 635-25-003-511 nxjerr:

Autoriteti Kontratkues , me datën 22.04.2025 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

A.K pas analizes se kërkeses se juaj për Ri-shqyrtim duke marr për bazë kërkesën tuaj në platformën elektronike të datës: 20.04.2025 ,e ka trajtuar me kujdes kërkesën tuaj, dhe ka arritur në përfundim se njejtë është e pa bazuar.,

Pretendimet e O,E 1

Autoriteti kontraktues publikoj Njoftimin për Dhënie të Kontratës me tenderues fitues CAPITAL X FET SHPK perkunder qe OE ne fjale ka mangesi te medha ne dokumentacionin teknik .

Autoriteti kontraktues ka bere shkelje Ligjore duke na eliminuar perkunder qe dokumentacioni teknik i jone ka qene i kompleuar.

1. Ne FDT kerkesa 3: një (1) inxhinier i diplomuar i arkitekturës ose master me minimum 5 vite përvojë punë si dhe të ketë minimum (1) projekte nga lëmia e kërkuar pas diplomimit.Të jetë i trajnuar për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Kompania fituese CAPITAL X FET SHPK ka ofruar nje bachelor te arkitektures i cili as qe eshte i certifikuar per shendet dhe siguri ne pune dhe nuk ka kualifikim master apo inxhinier i diplomuar.

2. Kërkesa 3.1

Një (1) inxhinier i diplomuar ose master i elektros drejtimi elektronike me minimum 5 vite përvojë punë si dhe të ketë minimum (1) projekte nga lëmia e kërkuar pas diplomimit.Të jetë certifikuar ne auditim i energjise ne ndertesa dhe ndriqim public

Kompania nuk ka te bashkangjitur asnje inxhinier te profilit te tille

Pergjegjia nga A,K 1,

Lidhur me pretendimet e paraqitura në kuadër të procedurës së prokurimit, Komuna e Pejës njofton se ka vepruar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe me rregullat përkatëse të prokurimit.

Autoriteti kontraktues ka përzgjedhur Operatorin Ekonomik fitues bazuar në kriterin për çmimin më të ulët, në përputhje me specifikat dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Sa i përket pretendimeve tuaja për mungesë të dokumentacionit të kërkuar nga ana e OE-së fitues, ju informojmë se ato nuk qëndrojnë, për arsye se:

Operatorit Ekonomik, për kërkesën 3, ka prezantuar stafin profesional të kërkuar, përfshirë inxhinierët e fushës përkatëse;

Inxhinieri i Elektroinstalimeve është i përfshirë në ekipin e ofruar dhe i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara;

OE ka dorëzuar certifikatat përkatëse të auditimit, siç janë kërkuar në dosje të tenderit.

Në këtë drejtim, të gjitha dokumentet janë vlerësuar konform kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në përputhje me nenin 59 të LPP-së, që ndërlidhet me vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e operatorit më të përgjegjshëm.

Duke u bazuar në sa më sipër, me keqardhje ju informojmë se pretendimet tuaja ankimore në këtë pikë vlerësohen si të pabazuara dhe pa ndikim në rezultatet e vlerësimit dhe përzgjedhjes.

Pretendimet e O,E 2

Nje(1) inxhinier(master) I diplomuar i ndertimtarise-drejtimi infrastrukture Kompania ka bashkangjitur nje inxhinier te ndertimtarise konstruktiv dhe jo te

profilit te kerkuar ne dosjen e tenderit qe kerkohet drejtimi infrastrukture .

Poashtu kompania nuk ka ofruar nje liste te stafit qe do te jete i angazhuar ne kete projekt me profilet e kerkuara te dosjes se tenderit.

Andaj stafi as perafrohet kerkesave te dosjes se tenderit.

Makineria dhe Mjetet e Punës të disponueshme për OE ; Kerkohet ne FDT 1. Ngarkues me lopat max 3.5ton -1copë Kompania nuk ka ofruar nje ngarkues te tille me max 3.5 ton ,ka bashkangjitur eskavator mirpo jo me te tilla performanca. 2. Damper minm 1deri 1.5ton- minm 1copë Kompania nuk ka te bashkangjitur damper 3. Cilinder rruge min14ton-1cop Kompania nuk ka te bashkangjitur cilinder 4. Autovinç minm 10deri 14ton- minm 1cop Kompania nuk ka te bashkangjitur Autovinç Bazuar në të dhënat e paraqitura, është evidente se kompania CAPITAL X FET SHPK nuk posedon kapacitet të mjaftueshëm as administrativ, as ekzekutues për realizimin e kontratës në fjalë. Dokumentacioni i dorëzuar është i mangët, pjesërisht i pavlefshëm dhe në kundërshtim me kërkesat teknike të tenderit. Për më tepër, lejimi i kualifikimit të një operatori të tillë dëmton rëndë konkurrencën e ndershme, si dhe kompanitë serioze që investojnë në staf profesional dhe kapacitete reale

Pergjegjia nga A,K 2,

Në lidhje me pretendimin tuaj sa i përket stafit profesional dhe listës së pajisjeve/makinerive të ofruara nga Operatorit Ekonomik i shpërblyer me kontratë, ju njoftojmë se këto pretendime nuk qëndrojnë, për arsye se:

- OE ka prezantuar listën e stafit profesional, përfshirë inxhinierët e kërkuar sipas specifikimeve në Dosjen e Tenderit;
- Gjithashtu, OE ka paraqitur listën e pajisjeve dhe makinerive, të cilat janë në përputhje të plotë me kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit;
- Dokumentacioni i ofruar është shqyrtuar dhe vlerësuar me kujdes nga Komisioni Vlerësues, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregulloren përkatëse për Vlerësimin e Ofertave.

Bazuar në shqyrtimin dhe vlerësimin e kryer nga Komisioni, është konstatuar se oferta juaj nuk përmbush të gjitha kërkesat esenciale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, prandaj është cilësuar si jo e përgjegjshme, në përputhje me nenin 6 dhe nenin 59 të LPP-së.

Si rrjedhojë, pretendimet e paraqitura në ankesën tuaj janë vlerësuar si të pabazuara, dhe nuk ndikojnë në vendimin për përzgjedhjen e OE-së fitues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane me lartë ka vendosur si ne dispozitiv Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP- se duhet te dorezohet brenda afatit ligjor .

Vendimi i dorëzohet:

1. Një (1) kopje ngarkohet për mes platformës elektronike
2. Një (1) kopje – Arhivës A.K Komuna e Pejës.

Me respekt
MILOT GASHI
Menaxher i Prokurimit